



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:151400
Datë: 26.03.2025
Numri i dokumentit: 07046646

Ac.nr.8213/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Qerim Ademaj - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. K., nga fshati T., Komuna e P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Isa Salihi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës B. K.e S. (BKS), me seli në P., e përfaqësuar nga e autorizuar Mimoza Kllokoqi, nga Prishtina, për shkak zhdëmtimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1456/18 të datës 08.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës B. K. e S. (BKS), me seli në P., ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1456/18 i datës 08.09.2022, **VËRTETOHET**.

II. Pika I dhe II e dispozotivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1456/18 i datës 08.09.2022, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.1456/18 të datës 08.09.2022 ka vendosur në këtë mënyrë:

PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Sh. K., nga fshati T., Komuna e Pejës, ashtu që :

I.DETYROHET e paditura B. K. e S. (BKS), me seli në P., që në emër të dëmit material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor me dt.21.07.2018, në bazë të sigurimit të detyruar të auto përgjegjësisë(sigurimit kufitar), paditësit t’ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë, dhe atë:

në emër të dëmit material:

- për automjetin e dëmtuar, shumën prej..... 19.887€
- për blerjen e biletës se aeroplanit, shumën prej..... 429€

II. **PJESËRISHT REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Sh. K.**, nga fshati T., Komuna e P., përtej shumës së gjykuar si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit material, dhe atë shumat e specifikuar si në vijim: për automjetin e dëmtuar, shumën prej 19.887,00€, për blerjen e biletës së aeroplanit, shumën prej 429,50€, **SI E PA BAZUAR.**

III. **DETYROHET e paditura B. K. e S. (BKS)**, me seli në P., që paditësit Sh. K., nga fshati T., Komuna e P., për shumat e gjykuara si në pjesën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 20.316,50€, me kamat ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga dt.08.09.2022, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 2.016,00€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër Aktgjykimit brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovojë ankesën e të paditurës sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Paditësi ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që të vërtetohet Aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 27.12.2018, të precizuar përmes parashtrësës së datës 27.08.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurës për kompensimin e dëmit.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat, ndërsa pas vlerësimit të tyre ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr konform nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së, ashtu që e paditura është e obliguar që paditësit të i'a paguaj shumën prej 2.016,00€, dhe atë: për përpilim të padisë shumën prej 208€, për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 208€, për përfaqësim në pesë(5) seanca të mbajtura nga 270,40€ për seancë, dhe atë në shumën prej 1.352€, për taksën gjyqësore në shumë prej 100€, dhe shpërblimin për dy ekspert (nga 100€), dhe atë në shumë prej 200€.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me

zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën.

Kjo gjykatë, ka vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shpenzimet procedurale, andaj refuzohen si të paqëndrueshme pretendimet ankimore kundrejt tij. Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Pika I dhe II e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1456/18 i datës 08.09.2022, që ka të bëjë me pjesën e aprovuar pjesërisht të kërkesëpadsisë së paditësit ndaj të paditurës në emër të kompensimit të dëmit material në shumë tërësishme prej 20,316.50 Euro, bazuar në nenin 194 të LPK-ës mbeten të pashqyrta, me arsyetim se asnjëra palë ndërgjyqëse nuk ka parashtruar ankesë për këtë pjesë të Aktgjykimit.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8213/2022, datë 25.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi